



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2023:054012

Datë: 03.04.2024

Numri i dokumentit: 05539683

P.nr../..

GJYKATA THEMELORE NË PEJË DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL gjyqtari i vetëm gjykues Musë Povataj, me pjesëmarrje të bashkëpunëtores profesionale Edona Berisha Kastrati, në çështjen penale ndaj të pandehurit G.. V.. për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë Departamenti i Përgjithshëm PP/II nr.324/23 të datës 28.02.2024 jashtë seancës gjyqësore me datë 03.04.2024 bie këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET marrëveshja për ndërmjetësim Nd.nr../.. e datës 20.02.2024, lidhur në mes të pandehurit G.. V.. dhe përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar K.. sh.a në Pejë.

II. HUDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Pejë Departamenti i Përgjithshëm PP/II nr.324/23 të datës 28.02.2024.

III. PUSHOHET procedura penale ndaj të pandehurit G.. V.., i lindur me datë në K. Pejë, ku edhe tani banon në rr. “Gj.. F..” nr. ..., nga babai Sh.. dhe nënës Z.., i njohur me numër personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

- për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve” nga neni 314 par. 1 të KPRK-së.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamentit të Përgjithshme me datën 28.02.2023 ka ngritur aktakuzën PP/II nr.324/23 ndaj të pandehurit G.. V.. për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 1 të KPRK-së.

Me datën 20.02.2024 është arrit marrëveshja në zyrën e ndërmjetësimit në mes të pandehurit G.. V.. dhe përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar K.. sh.a në Pejë, e cila marrëveshje i është dozuar gjykatës ne kopje të mjaftueshme.

Nga te cekurat me lartë gjykata ka vendosur si ne pikën I të dispozitiv të këtij aktvendimi duke e pranuar marrëveshja për ndërmjetësim Nd.nr../.. e datës 20.02.2024, lidhur në mes të pandehurit dhe përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar K.. sh.a në Pejë.

Me dispozitën ligjore të nenin 229 par. 5 të KPRK-së është përcaktuar se: nëse aktakuza është dorëzuar, gjyqtari i vetëm gjykues, nëse e pranon formalisht marrëveshjen, merr vendim për të hedhur aktakuzën dhe e ndërpre në procedurën penale.

Andaj nga të cekurat më lartë e në kuptim 229 par.5 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL
2023:054012, 03.04.2024**

Bashkëpunëtorja Profesionale

G j y q t a r i

Edona Berisha Kastrati

Musë Povataj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi palët kanë te drejtë të parashetrojnë ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate, në afat prej 3 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi